



KRYETARI I KOMUNËS
MUNICIPAL PRESIDENT
PRESDENNIK OPSTINE

Tel / Fax: 038/200-46002
Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net

DATA/DATUM/DATE	11.02.2026
NR/BR.	01.Nr.35/26
PËR/ZA/TO	Kuvendin e Komunës së Ferizajt
PËRMES/PREKO/THROUGH	Xhavit Zariqi, Kryesues i Kuvendit të Komunës
NGA/OD/FROM	Agim Aliu, Kryetar i Komunës së Ferizajt
LËNDA/PREDMET/SUBJECT	Propozim – Vendim për caktimin e katër (4) anëtarëve nga Kuvendi i Komunës për përfaqësues në AKK.

Në bazë të dispozitave të nenit 58 pika 1.h të Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr.28/15 Qershor 2008), nenit 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës Ferizaj, 01.Nr.50 të datës 28.06.2013 si dhe në bazë të kërkesës së Asociacionit të Komunave të Kosovës, për caktimin e anëtarëve nga radhët e Kuvendit të komunës dhe në bazë të formulës së zgjedhjes së deritanishme ku përpos Kryetarit të Komunës, Kuvendi ka të drejtë të delegoi për çdo dhjetë anëtarë, një përfaqësues në AKK, propozohet caktimi i 4 anëtarëve nga Kuvendi i Komunës Ferizajt.

**PROPOZIM - VENDIM
PËR CAKTIMIN E KATËR (4) ANËTARËVE NGA KUVENDI I KOMUNËS PËR
PËRFAQËSUES NË AKK**

Në bazë të kësaj Propozim-Formule, si dhe duke u mbështetur në rezultatet e zgjedhjeve të fundit për Kuvendin Komunal, propozohet që Komuna e Ferizajt të përfaqësohet në AKK në këtë përbërje:

- LDK – një anëtar i Kuvendit Komunal
- PDK – dy anëtar të Kuvendit Komunal
- LVV – një anëtar i Kuvendit Komunal

Ju njoftojmë se kjo është vetëm **formulë orientuese/propozuese** e AKK-së. Megjithatë, dëshirojmë të theksojmë se vendimin final për përfaqësim e marrin Kuvendet Komunale përkatëse, dhe se delegimi i përfaqësuesve duhet të miratohet me vendim formal nga Kuvendi Komunal, në përputhje me procedurat ligjore dhe statutore.